

# Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare

“Credins INVEST” sh.a.,

Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe  
Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

# Përmbajtja

	<b>Faqe</b>
Raporti i Audituesit të Pavarur	i-iii
Pasqyra e Pozicionit Financiar	1
Pasqyra e Fitim ose Humbjes dhe të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital	3
Pasqyra e Flukseve të Parasë	4
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare	5-28

## Raporti i Audituesit të Pavarur

Për aksionarët e “Credins Invest” sh.a, Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

### *Opinionit*

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë Administruese të Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive “Credins Invest” sh.a (“Shoqëria”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2020, pasqyrën fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare individuale bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 dhjetor 2020, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me kërkesat e raportimit financiar.

### *Bazat për Opinionin*

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesionistë të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### *Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në Lidhje me Pasqyrat Financiare*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e raportimit financiar për Shoqëritë, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedurën auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencën auditimi të plotë dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontroleve të brendshme.
- marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedurën të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontroleve të brendshme të entitetit.
- vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga drejtimi, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese.
- konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.

- vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

**Grant Thornton sh.p.k.**

Tiranë, Shqipëri

16 prill 2021

*Kledian Kodra, FCB*



**“Credins Invest” sh.a, Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive**

**Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

## Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënime	31 dhjetor 2020 në LEK	31 dhjetor 2019 në LEK
<b>AKTIVET</b>			
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	6	8,492,344	24,140,788
Kuota në Fond investimi të mbajtura me VDPFH	7	23,252,619	-
Depozita me afat	8	17,000,000	17,000,000
Të arkëtueshme nga Fondet	9	5,498,372	5,302,407
Aktive të tjera	10	1,936,741	1,406,052
Aktive me të drejtë përdorimi	11	4,311,786	4,177,064
Letra me vlerë të mbajtura me kosto të amortizueshme	12	10,139,884	-
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara, neto	13	2,236,556	2,982,068
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara, neto	14	5,946,006	5,344,675
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>78,814,308</b>	<b>60,353,054</b>
<b>DETYRIMET</b>			
Detyrime të tjera	15	6,424,169	3,437,242
Detyrime qera financiare	16	4,311,786	4,244,512
<b>Total i detyrimeve</b>		<b>10,735,955</b>	<b>7,681,754</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapital i paguar	17	95,822,394	95,822,394
Rezerva Ligjore	17	10,000,000	10,000,000
Humbje të mbartura		(37,744,041)	(53,151,094)
<b>Total i Kapitalit</b>		<b>68,078,353</b>	<b>52,671,300</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>78,814,308</b>	<b>60,353,054</b>

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga drejtimi i Shoqërisë Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimit Kolektive “Credins Invest” sh.a., më 24 shkurt 2021 dhe janë firmosur nga:

Znj. Estela Koci  
Administratore e Përgjithshme

Znj. Armira Citozi  
Drejtoreshë Finance dhe Kontabiliteti

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënime shpjeguese në faqet 5 deri në 28 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave.

**“Credins Invest” sh.a, Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive**

**Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

## Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga tarifat e administrimit	18	63,594,698	52,313,333
Të ardhura nga penalitete	19	1,855,336	1,870,341
Të ardhura të tjera		4,500	10,917
Të ardhurat nga interesat	20	1,258,672	928,981
Shpenzime të qirasë financiare	16	(142,179)	(390,791)
Të ardhura nga dhurata dhe ndihma të marra	21	-	62,824
		<b>66,571,027</b>	<b>54,795,605</b>
Shpenzime për personelin	22	(26,393,779)	(24,715,635)
Zhvlërësimi dhe amortizimi	13,14	(6,192,922)	(6,549,231)
Shpenzime të përgjithshme administrative	23	(12,831,842)	(11,561,861)
		<b>(45,418,543)</b>	<b>(42,826,727)</b>
Fitim/(humbja) nga kursi i këmbimit		(137,164)	49,379
<b>Fitimi/(humbja) para tatimit</b>		<b>21,015,320</b>	<b>12,018,257</b>
Tatim mbi fitimin	2	(3,276,262)	(358,231)
<b>Fitimi/(humbja) neto pas tatimit</b>		<b>17,739,058</b>	<b>11,660,026</b>
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse</b>			
Rivlerësimi i aktiveve financiare të vlefshme për shitje			
Efekt i tatim fitimit të shtyrë			
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për t'u riklasifikuar në fitim ose humbje në periudhat pasardhëse:</b>		<b>17,739,058</b>	<b>11,660,026</b>
<b>Totali i te ardhurave/(humbjes) gjithëpërfshirëse për pronarët, pas tatimit mbi fitimin</b>		<b>17,739,058</b>	<b>11,660,026</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 28 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave.

**“Credins Invest” sh.a. Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive**  
 Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2020  
 (të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

## Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

	Kapitali i paguar	Kapitali i nënshkruar, i paregjistruar	Kapitali i papaguar	Rezerva ligjore	Rezerva rivlerësimi	Humbje e mbaratur	Totali
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>95,822,394</b>	-	-	<b>10,000,000</b>	-	<b>(64,811,120)</b>	<b>41,011,274</b>
Fitimi neto i vitit	-	-	-	-	-	11,660,026	11,660,026
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-	-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>	-	-	-	-	-	<b>11,660,026</b>	<b>11,660,026</b>
<b>Transaksione me pronarët e Shoqërise, të njohura direkt në kapital:</b>							
Rritje në kapital	-	-	-	-	-	-	-
Ulje në kapitalin e nënshkruar, të paregjistruar, për pjesën e papaguar	-	-	-	-	-	-	-
Ulje në kapitalin e nënshkruar, të paregjistruar	-	-	-	-	-	-	-
<b>Totali i kontributeve dhe shpërndarje tek pronarët</b>	-	-	-	-	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>95,822,394</b>	-	-	<b>10,000,000</b>	-	<b>(53,151,094)</b>	<b>52,671,300</b>
Fitimi neto i vitit	-	-	-	-	-	17,739,058	17,739,058
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-	-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>	-	-	-	-	-	<b>17,739,058</b>	<b>17,739,058</b>
<b>Transaksione me pronarët e Shoqërise, të njohura direkt në kapital:</b>							
Rritje në kapital	-	-	-	-	-	(2,332,005)	(2,332,005)
Ulje në kapitalin e nënshkruar, të paregjistruar, për pjesën e papaguar	-	-	-	-	-	-	-
Ulje në kapitalin e nënshkruar, të paregjistruar	-	-	-	-	-	-	-
<b>Dividendë të paguar</b>	-	-	-	-	-	<b>(2,332,005)</b>	<b>(2,332,005)</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>95,822,394</b>	-	-	<b>10,000,000</b>	-	<b>(37,744,041)</b>	<b>68,078,353</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 28 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave.



**“Credins Invest” sh.a, Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kollective**

Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

## Pasqyra e Flukseve Monetare

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020 në LEK	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019 në LEK
<b>Fluksi parasë nga aktiviteti operacional</b>		
Fitimi/ (humbja) para tatimit	21,015,320	12,018,257
<i>Rregullime për:</i>		
Të ardhura nga tarifa e administrimit dhe penalitete	(65,450,034)	(54,194,591)
Të ardhurat nga interesat e depozitave	(1,263,172)	(928,387)
Interesat e qerasë	142,179	390,791
Detyrim qera financiare	4,169,607	3,853,721
Aktive me të drejtë përdorimi	(8,556,298)	(8,354,721)
Të ardhura nga dhurata dhe ndihma të marra	-	(62,824)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	6,192,922	6,549,231
	<b>(43,749,476)</b>	<b>(40,728,523)</b>
<i>Ndryshimet në kapitalin qarkullues:</i>		
Falje aktive	-	62,824
Pakësim në aktive të tjera	(537,531)	(632,491)
Rritje në detyrime të tjera	(289,335)	718,766
	<b>(826,866)</b>	<b>149,099</b>
Interes i fituar	1,017,395	931,310
Të ardhura të përfituara nga tarifa administrimit dhe penalitete	65,254,069	51,963,689
<b>Rrjedhja e parasë neto e gjeneruar në aktivitetin operacional</b>	<b>21,695,122</b>	<b>12,315,575</b>
Blerje e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	(1,897,555)	(432,580)
Falje aktive	25,878	87,575
Investim në kuota	(23,000,000)	-
Blerje letra me vlere	(10,139,884)	-
Rrjedhja e parasë neto e përdorur nga aktivitetet investuese	<b>(35,011,561)</b>	<b>(345,005)</b>
<b>Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financuese</b>		
Shpërndarje dividendi	(2,332,005)	-
<b>Rrjedhja neto nga aktivitetet financuese</b>	<b>(2,332,005)</b>	<b>-</b>
<b>Rritja neto në para dhe ekuivalentët e saj</b>	<b>(15,648,444)</b>	<b>11,970,570</b>
<b>Para dhe ekuivalentë në fillim të periudhës</b>	<b>24,140,788</b>	<b>12,170,218</b>
<b>Para dhe ekuivalentë në fund të periudhës</b>	<b>6</b>	<b>8,492,344</b>
		<b>24,140,788</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 28 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave.

# Shënime Shpjeguese për Pasqyrat Financiare

## 1. Informacion i përgjithshëm

“CREDINS INVEST” sh.a., Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimit Kolektive (në vijim “Shoqëria”) është një shoqëri aksionare shqiptare, e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar me Vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë Nr. 34260, më datë 31 Tetor 2005 dhe me seli në Rrugën “Nikolla Tupe”, Nr. 1, Kati 3, Tiranë.

Shoqëria fillimisht u liçencua nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare më datë 23 nëntor 2011, me licencën nr. 3, për të vepruar si Shoqëri Administruese e fondeve të pensionit vullnetar, në mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensionit vullnetar dhe kryerjen e pagesave të pensionit sipas Ligji Nr.10197, datë 12 dhjetor 2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”.

Më 30.05.2016, Shoqëria u pajis me licencën nr. 3, për të administruar asetet e sipërmarrjeve të investimeve kolektive në përputhje me dispozitat e ligjit nr.10198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", krahas veprimtarisë për administrimin e fondeve të pensionit vullnetar. Emri i Shoqërisë u ndryshua në “CREDINS INVEST” sh.a. Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Vullnetar dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive.

Shoqëria ka në administrim një fond pensioni vullnetar, me emrin “Credins Pension” miratuar më 13 dhjetor 2011 me vendimin Nr. 173 të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare; dhe një fond investimi me emrin “Credins Premium”, miratuar më 30 maj 2016 me vendimin Nr. 85 të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Fondi i Investimit ka filluar veprimtarinë e tij më 1 korrik 2016.

Banka Depozitare e Fondit të Pensionit është Banka e Tiranës sh.a., miratuar me Vendimin Nr.91, datë 18 Korrik 2012, të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Banka Depozitare e Fondit “Credins Premium” është Banka Amerikane e Investimeve sh.a., miratuar me Vendimin Nr.2, datë 31 Janar 2018, të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Shoqëria Administruese dhe Depozitari janë të detyruara të mbajne të ndara aktivet, veprimet dhe regjistrimet e veta, nga aktivet, veprimet, dhe regjistrimet e Fondit të Pensionit Vullnetar, si dhe Fondit të Investimeve, e për këtë arsye edhe raportimet për shoqërinë dhe Fondet paraqiten të ndara.

Shoqëria Administruese e Fondeve “Credins Invest” Sh.a., pas licenses lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me Vendimin nr.206 datë 29.12.2020 për miratimin e përshtatshmërisë së shoqërisë dhe Vendimin nr.207 datë 29.12.2020 për licensimin e shoqërisë “Credins Invest” për ofrimin e Fondeve të Investimit Alternative vetëm për klientët profesionistë dhe të kualifikuar dhe në përputhje me Ligjin nr. 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, ushtron veprimtarinë e administrimit të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive me ofertë publike, administrimin e fondeve të investimeve alternative vetëm për klientët profesionistë dhe të kualifikuar dhe administrimin e fondeve të pensionit vullnetar.

Më 31 Dhjetor 2020, Shoqëria ka të punësuar 16 punonjës dhe drejtues të lartë (2019:13).

## **2. Bazat e përgatitjes**

### **2.1 Bazat e përputhshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Kuadri kontabël i aplikuar është i bazuar në politikat kontabël të listuara në shënimin nr. 3, të cilat janë të bazuara në vlerësimin, paraqitjen, dhe parimet kontabël sipas Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Më poshtë paraqiten parimet kryesore të politikave kontabël të aplikuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

### **2.2 Bazat e matjes**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike përveç aktiveve financiare të vlefshme për shitje, të cilat janë paraqitur me vlerë të drejtë.

### **2.3 Monedha funksionale dhe e prezantimit**

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në monedhën shqiptare “Lekë”, e cila është monedha funksionale. Përveç rasteve kur është shënuar ndryshe, informacioni financiar është paraqitur në Lekë.

### **2.4 Përdorimi i vlerësimit dhe i gjykimit profesional**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga ato të çmuara. Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen. Shoqëria gjatë vitit 2020 ka investuar në kuota të pjesëmarrjes të klasifikuara si të mbatura me vlerën e drejtë përmes fitimit humbjes. Vlerë e drejtë e kuotave përcaktohet në bazë të pjesëmarrjes në aktiveve neto të fondit të cilat riveleshohen mbi baza ditore në propozicion të drejtë me vlerën e drejtë të investimeve të fondit.

#### **2.4.1 Parimi i vijimësisë**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në bazë të vijimësisë, i cili supozon që shoqëria do të vazhdojë veprimtarinë operacionale dhe në periudhat në vazhdim. Shoqëria kryen në mënyrë frekvente provat e rezistencës për Fondin e investimit me qëllim përcaktimin e likuiditetit të nevojshëm në kushte të tensionuara tregu. Ajo përcakton edhe impaktin që mund të kenë skenarët e ndryshëm të parashikuar në provat e rezistencës, në tarifën e administrimit të Fondit nga Shoqëria administruese. Më 24 mars 2020, me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 243, në Shqipëri u shpall gjendja e fatkeqësisë natyrore, si pasojë e përhapjes së virusit COVID19 dhe klasifikimit të tij si pandemi nga Organizata Botërore e Shëndetësisë më 11 mars 2020. Në kuadër të frenimit të përhapjes së COVID-19, një sërë masash u ndërmorën nga Qeveritë e shteteve, masa të cilat u reflektuan edhe në Shqipëri. Duke filluar që nga muaji Mars, Qeveria vendosi pezullimin e të gjithë aktiviteteve të cilat nuk ishin jetike. Pandemia Covid-19 ka pasur një ndikim të konsiderueshëm edhe në volatilitetin e tregjeve financiare në tregun vendas si edhe në tregjet e huaja. Rritja e kërkesës për borxh nga Qeveria e Shqipërisë, ndikoi në rritjen e normave të interesit, e cila solli një rënie të çmimit të instrumenteve financiare. Për pasojë, asetet e Fondit të Investimit të cilat riveleshohen në baza ditore me vlerën e drejtë, janë ndikuar nga luhatjet e normave të interesit. Gjithashtu, nisur nga pasiguria e krijuar në muajt e parë të pandemisë, Fondi i Investimit u përball me tërheqje të kuotave nga investitorët. Pavarësisht situatës së pazakontë, Shoqëria ka siguruar të ardhura nga administrimi më të larta se viti 2019, duke siguruar edhe një fitim neto më të lartë si pasojë e rritjes së vlerës së drejtë të investimeve të fondeve nën administrim. Drejtimi i Shoqërisë vlerëson se nuk ka pasiguri të qënësishme në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar vijimësinë e biznesit, për të ardhmen e parashikueshme, prej 12 muajsh nga data e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare. Si rrjedhojë, Drejtimi gjykon se parimi i vijimësisë është bazë e përshtatshme më përgatitjen e këtyre pasqyrave.

### **3. Përmbledhje e politikave kontabël**

Politikat kontabël të përmendura më poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente nga Shoqëria, në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare.

#### **3.1 Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit këmbehen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit të asaj date. Fitimi ose humbja nga kurset e këmbimit për zërat monetarë është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhë funksionale në fillim të vitit dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të këmbyerës me kursin e këmbimit në fund të vitit.

Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare të nominuara në monedhë të huaj, të cilat maten me vlerë të drejtë këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilën është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë në monedhë të huaj, të cilat maten me kosto historike këmbehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Kurset e këmbimit zyrtare bankare të zbatuara sipas Bankës së Shqipërisë (Lekë kundrejt njësisë së monedhës së huaj) për monedhën kryesore më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 ishin si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2020</b>	<b>31 dhjetor 2019</b>
EUR	123.70	121.77

#### **3.2 Plani i Kontributeve të Përcaktuara**

Nën planin e kontributeve të përcaktuara, shumat e përfitimeve të ardhshme është përcaktuar nga kontributet e paguara dhe nga interesat e fituara të fondit. Detyrimet janë njohur në fitim apo humbje në periudhën e duhur dhe janë paraqitur interese të shtuara të fondit të pensionit nga të ardhurat nga investimet.

#### **3.3 Standartet dhe amendimet e reja ose të ndryshuara**

##### **3.3.1 Standardet e reja të miratuara në 2020**

Standarde dhe amendamente të tjera, të cilat janë efektive për herë të parë në vitin 2020 (për një njësi ekonomike me fundin e vitit më 31 Dhjetor 2020) dhe mund të jenë të zbatueshme për Shoqërinë janë:

- Kombinimet e Biznesit (Amendament në SNRF 3)
- Kombinimet Materiale (Amendament në SNK 1 dhe SNK 8)
- Reforma e Referencës së Normës së Interesit (Amendamentet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7).
- Amendamentet në Referencat në kuadrin koncepti (Standarte të ndryshme).
- Koncesione të lidhura me qira COVID-19 (Amendamente në SNRF 16).

Këto amendamente nuk kanë një ndikim të rëndësishëm në këto Shembuj të Pasqyrave Financiare dhe për këtë arsye informacioni shpjegues nuk është dhënë. Sidoqoftë, edhe pse ato nuk ndikojnë këto Shembuj Pasqyrash Financiare, do të ndikojnë disa njësi ekonomike. Njësi ekonomike duhet të vlerësojë ndikimin e Standardeve të reja në pasqyrat e saj financiare bazuar në faktet dhe rrethanat e saj dhe të përfshijë informacionin e duhur shpjegues.

### **3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)**

#### **3.3 Standartet dhe amendimet e reja ose të ndryshuara (vazhdim)**

##### **3.3.2 Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende efektive dhe nuk janë miratuar më parë nga Shoqëria**

Standarde dhe amendamente të tjera që nuk janë ende efektive dhe nuk janë miratuar herët nga Shoqëria përfshijnë:

- NRF 17 Kontratat e Sigurimit
- Amendamentet në SNRF 17 Kontratat e Sigurimit (Amendamentet në SNRF 17 dhe SNRF 4)
- Referencat në Kuader Konceptuale
- Të ardhurat para përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16)
- Kontrata të rënda - Kostoja e përmbushjes së një kontrate (Ndryshimet në SNK 37)
- Përmirësimet vjetore të standardeve të SNRF-së 2018-2020 (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16, SNK 41)
- Klasifikimi i detyrimeve si aktuale ose jo-aktuale (ndryshime në SNK 1)

Këto amendamente nuk pritet të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare në periudhën e aplikimit fillestar dhe për këtë arsye informacioni shpjegues nuk është përfshirë. Megjithatë, edhe pse ato nuk kanë impakt në këto Shembuj të Pasqyrave Financiare, do të kenë në disa njësi ekonomike. Një njësi ekonomike duhet të vlerësojë ndikimin e parashikuar të këtyre Standardeve dhe amendamenteve të reja në pasqyrat e saj financiare duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e saj dhe duhet të përfshijë informacionin e duhur shpjegues.

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara, disa të reja por ende jo efektive, Standardet dhe amendamente në Standardet ekzistuese dhe Interpretimet janë publikuar nga IASB. Asnjë nga këto Standarde ose ndryshime në Standardet ekzistuese nuk kanë qenë miratuar herët nga Shoqëria.

Menaxhmenti parashikon që të gjitha standardet përkatëse do të miratohen për periudhën e parë duke filluar në ose pas datës efektive të shpalljes. Standardet e reja, amendamentet dhe interpretimet që nuk janë miratuar në vitin aktual nuk janë përfshirë në informacionin shpjegues pasi nuk pritet të kenë një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

#### **3.4 Instrumentat Financiare**

##### **3.4.1 Njohja dhe çrregjistrimi**

Aktivitet dhe detyrimet financiare njihen kur Shoqëria bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit financiar.

Aktivitet financiar çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar, ose kur aktivitet financiar transferohen dhe në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet transferohen.

Një detyrim financiar çregjistrohet kur shuhet, shlyhet, anulohet ose skadon.

### **3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)**

#### **3.4 Instrumentat Financiare (vazhdim)**

##### **3.4.2 Klasifikimi dhe matja fillestare e aktiveve financiare**

Përveç atyre të arkëtueshme tregtare që nuk përmbajnë një përbërës të konsiderueshëm financimi dhe maten me çmimin e transaksionit në përputhje me SNRF 15, të gjitha aktivet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit (aty ku është e aplikueshme).

Aktivitet financiare, të ndryshme nga ato të përcaktuara dhe efektive si instrumenta mbrojtës, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- Me kosto të amortizuar
- Me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVTPL)
- Me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI).

Klasifikimi përcaktohet nga:

- modeli i biznesit i njësisë ekonomike për menaxhimin e aktivitet financiar
- karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivitet financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me aktivet financiare që njihen në fitim ose humbje paraqiten brenda shpenzimeve financiare, të ardhurave financiare ose zërave të tjerë financiarë, me përjashtim të shpenzimeve zhvlerësimit të të arkëtueshmet tregtare të cilat përfshihen brenda shpenzimeve të tjera.

##### **3.4.3 Matja e mëpasshme e aktiveve financiare**

###### *i) Aktivitet financiare me kosto të amortizuar*

Aktivitet financiare maten me koston e amortizuar nëse plotësojnë kushtet e mëposhtme (dhe nuk janë paracaktuara si FVTPL):

- ato mbahen në kuadër të një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbajtja e mjeteve financiare dhe mbledhja e flukseve monetare kontraktuale
- kushtet kontraktuale të aktiveve financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar

Pas njohjes fillestare, këto maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre, shumica e të arkëtueshmeve të tjera, si dhe obligacioneve të listuara dhe letrat me vlerëbëjnë pjesë në këtë kategori të instrumenteve financiare.

###### *ii) Aktivitet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVTPL)*

Aktivitet financiare që mbahen në një model biznesi të ndryshëm nga "mbajtja për të mbledhur" ose "mbajtja për të mbledhur dhe shitur" kategorizohen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes. Më tej, pavarësisht nga modeli i biznesit, aktivitet financiare, flukset monetare kontraktuale të të cilave nuk janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit kalsifikohen në kategorinë FVTPL. Të gjitha instrumentet financiare derivative bien në këtë kategori, përveç atyre të paracaktuara si instrumente mbrojtës, për të cilët zbatohen kërkesat e kontabilitetit mbrojtës (shih më poshtë).

Kjo kategori gjithashtu përmban një investimet në kapital. Aktivitet në këtë kategori maten me vlerën e drejtë me fitime ose humbje të njohura në fitim ose humbje.

Vlera e drejtë e aktiveve financiare në këtë kategori përcaktohet duke iu referuar transaksioneve aktive të tregut ose duke përdorur një teknikë vlerësimi ku nuk ekziston një treg aktiv. Sipas kërkesave të SNRF 9 nuk lejohet mbajtja me kosto e këtyre aktiveve. Gjate vitit 2020 Shoqëria ka blere kuota investimi që i perkasin kesaj kategorie (shenimi 7).

### **3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)**

#### **3.4 Instrumentat Financiare (vazhdim)**

*iii) Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI)*

Shoqëria llogarit aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse FVOCI nëse aktivet plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- ato mbahen në një model biznesi objektivi i të cilit është "mbajtja për të mbledhur dhe shitur" dhe
- kushtet kontraktuale të aktiveve financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar.

Çdo fitim ose humbje e njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (OCI) do të riciklohet pas çrregjistrimit të aktivit.

##### **3.4.4 Zhvlerësimi i aktiveve financiare**

Kërkesat për zhvlerësim të SNRF 9 përdorin më shumë informacione të ardhshme për të njohur humbjet e pritshme të kreditit - 'modelin e humbjeve të pritshme të kreditit (ECL)'. Kjo zëvendëson SNK 39 'modelin e humbjeve të ndodhura'.

Instrumentet financiare në kuadër të kërkesave të reja përfshinin kreditë dhe aktivet e tjera financiare të borxhit të matura me koston e amortizuar, llogaritë e arkëtueshme, aktivet financiare të matura me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, aktivet e kontraktuara të njohura dhe të matur sipas SNRF 15 dhe angazhimeve të huasë dhe disa kontratave të garancisë financiare (për emetuesin) që nuk maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Njohja e humbjeve të kreditit nuk varet prej identifikimit të një ngjarjeje individuale të humbjes së kredisë mbi bazë individuale.

### **3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)**

#### **3.4 Instrumentat Financiare (vazhdim)**

##### **3.4.4 Zhvlerësimi i aktiveve financiare-(vazhdim)**

Në vend të kësaj, Shoqëria konsideron një gamë më të gjerë informacioni gjatë vlerësimit të rrezikut të kredisë dhe matjen e humbjeve të pritshme të kreditit, duke përfshirë ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale, parashikimet e arsyeshme dhe të mbështetura që ndikojnë në arkëtueshmërinë e pritshme të flukseve monetare të ardhshme të instrumentit.

Në zbatimin e kësaj qasjeje të ardhshme, bëhet një dallim midis:

- instrumentet financiare që nuk janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare ose që kanë rrezik të ulët të kredisë ('Faza 1') dhe
- instrumentet financiare që janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare dhe rreziku i kredisë i të cilit nuk është i ulët ('Faza 2').

'Faza 3' do të mbulonte aktivet financiare që kanë tregues objektivë të zhvlerësimit në datën e raportimit.

Humbjet e pritshme të kreditit '12 - mujore' njihen për kategorinë e parë, ndërsa 'humbjet e pritshme të kreditit përgjatë jetës së instrumentit' njihen për kategorinë e dytë.

Matja e humbjeve të pritshme të kredisë përcaktohet nga një vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve të kredisë gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar.

Shoqëria nuk ka identifikuar dhe njohur zhvlerësim për aktivet financiare më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 pasi efekti është jomaterial për pasqyrat financiare.

##### *i) Klasifikimi dhe matja e detyrimeve financiare*

Detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë dhe, kur është e aplikueshme, përshtaten për kostot e transaksionit, përveç nëse Grupi ka përcaktuar një detyrim financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Më pas, detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveç derivativave dhe detyrimeve financiare të përcaktuara në FVTPL, të cilat mbahen më pas me vlerën e drejtë me fitimet ose humbjet të njohura në fitim ose humbje (përveç instrumenteve financiare derivative të cilat janë të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse).

Të gjitha pagesat lidhur me interesin dhe, nëse është e zbatueshme, ndryshimet në vlerën e drejtë të një instrumenti që raportohen në fitim ose humbje përfshihen në kostot financiare ose të ardhurat financiare.

##### **3.4.5 Instrumentet financiare derivative dhe kontabiliteti mbrojtës**

Instrumentet financiare derivative llogariten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes (FVTPL) me përjashtim të derivateve të përcaktuara si instrumente mbrojtës në marrëdhëniet mbrojtëse të flukseve monetare, të cilat kërkojnë një trajtim të veçantë kontabël. Për t'u kualifikuar për kontabilitetin mbrojtës, marrëdhënia mbrojtëse duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e mëposhtme:



### **3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)**

#### **3.4 Instrumentat Financiare (vazhdim)**

##### **3.4.5 Instrumentet financiare derivative dhe kontabiliteti mbrojtës (vazhdim)**

- Ekziston një marrëdhënie ekonomike midis zërit të mbrojtur dhe instrumentit mbrojtës
- Efekti i rrezikut të kredisë nuk dominon ndryshimet e vlerës që rezultojnë nga ajo ekonomike
- Raporti i mbrojtjes i marrëdhënies mbrojtëse është i njëjtë me atë që rezulton nga sasia e elementit të mbrojtur që njësia ekonomike aktualisht mbron dhe sasia e instrumentit mbrojtës që njësia ekonomike aktualisht përdor për të mbrojtur atë sasi të elementit të mbrojtur.

Të gjitha instrumentet financiare derivative të përdorura për kontabilitetin mbrojtës njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe raportohen më pas me vlerën e drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar.

Në masën që mbrojtja është efektive, ndryshimet në vlerën e drejtë të derivativëve të përcaktuar si instrumente mbrojtës në mbrojtjen e fluksit të mjeteve monetare njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse dhe përfshihen në rezervën mbrojtëse të fluksit të mjeteve monetare në kapitalin neto.

Çdo ineficence në marrëdhënien mbrojtëse njihet menjëherë në fitim ose humbje.

Në kohën kur elementi i mbrojtur ndikon në fitimin ose humbjen, çdo fitim ose humbje e njohur më parë në të ardhurat e tjera përmbledhëse riklasifikohet nga kapitali neto në fitim ose humbje dhe paraqitet si një riklasifikim brenda të ardhurave të tjera përmbledhëse. Megjithatë, nëse një aktiv ose detyrim jofinanciar është njohur si rezultat i transaksionit të mbrojtur, fitimet dhe humbjet e njohura më parë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse përfshihen në matjen fillestare të elementit të mbrojtur.

Nëse një transaksion i ardhshëm nuk pritet të ndodhë, çdo fitim ose humbje e njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse bartet menjëherë në fitim ose humbje. Nëse marrëdhënia mbrojtëse pushon të përmbushë kushtet e efektivitetit, kontabiliteti mbrojtës ndërpritet dhe fitimi ose humbja në fjalë mbahen në rezervën e kapitalit neto derisa të ndodhë transaksioni i ardhshëm.

#### **3.5 Mjete monetare dhe ekuivalentë me to**

Mjete monetare në arkë dhe bankë përfshijn gjendjet monetare në arkë, paratë e vendosura në banka dhe investime mjaft likuide afat-shkurtra me maturitet më pak ose deri në tre muaj nga momenti i blerjes.

#### **3.6 Kuota në Fond Investimi**

Kuota në Fond Investimi përfaqsojnë blerjet e kuotave të fondit Credins Premium I cili administrohet nga shoqëria. Fondi investon kryesisht në mjete monetare, depozita bankare dhe tituj borxhi me të ardhura fikse të Qeverisë Shqiptare, me profil rreziku të ulët (niveli 2 sipas prospektit të Fondit). Asetet e Fondit vlerësohen me vlerë të drejtë me bazë ditore dhe cmimi i kuotës publikohet çdo ditë. Investimi ë Fond konsiderohet me likuiditet të lartë pasi shlyerja e kuotave ndodh Brenda 7 ditëve nga data e kërkesës.

#### **3.7 Depozita me afat**

Depozitat me afat janë vendosur në pasqyrën e pozicionit financiar në shumën e principalit dhe janë klasifikuar si të tilla ato me maturitet më shumë se tre muaj. Interesi është përllogaritur në baza rritëse dhe interesi i arkëtueshëm pasqyrohet në të arkëtueshme të tjera.

### **3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)**

#### **3.8 Aktive afatgjata materiale**

*i) Njohja dhe matja*

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë paraqitur me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivitetit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga drejtimi. Blerja e programeve që janë të lidhur ngushtë me funksionalitetet e pajisjes përkatëse janë kapitalizuar si një pjesë e kësaj pajisje. Kur pjesët e një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elementë të veçantë (komponentet kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

*ii) Kosto të mëtejshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Shoqëri dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin kur ndodhin.

*iii) Zhvlerësimi*

Amortizimi njihet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave me metodën e vlerës së mbetur. Aktivitetet me qira zhvlerësohen për më të voglën mes periudhës së qirasë dhe jetëgjatësisë së dobishme.

Norma e amortizimit vjetor është si me poshtë:

Pajisje zyre	20 %
Pajisje informatike	25 %

#### **3.9 Aktive të patrupëzuara**

Aktivitetet e patrupëzuara njihen me kosto historike, zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Shpenzimet e mëvonshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik të këtij aktiviteti. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin tek pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, bazuar në metodën e vlerës së mbetur. Norma e amortizimit vjetor është 25%.

#### **3.10 Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare**

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç aktiveve tatimore të shtyra, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidencë për zhvlerësim. Nëse ka evidencë të tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Humbja nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aktiviteti ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme të aktivitetit. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare që janë të pavarura nga aktivitetet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave. Vlera e rikuperueshme e një aktiviteti, ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës së tij në përdorim.

### **3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)**

#### **3.11 Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare-**

Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuar të ardhshme të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin. Humbjet e mëparshme rishikohen në çdo datë raportimi për të vlerësuar nëse ka evidencë se rënia në vlerë është zbutur, ose nuk ekziston më. Një humbje anulohet nëse ka evidencë se nuk ka zhvlerësim dhe ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke zbritur zhvlerësimin apo amortizimin dhe sikur të mos ishte njohur më parë ndonjë humbje nga rënia në vlerë.

#### **3.12 Kapitali aksioner**

Kapitali aksionar paraqitet në vlerën e tij nominale. Kapitali aksionar i cili është i nënshkruar për emetim, por që ende nuk është i regjistruar është i paraqitur veçmas në pasqyrën e lëvizjes së kapitalit. Një kontribut i pafinancuar i kapitalit, i cili është i pagueshëm në të ardhmen në një shumë të parapërcaktuar, është klasifikuar si kapital i paregjistruar dhe i papaguar, përveç rasteve kur marrja e kontributit është vlerësuar në mënyrë të arsyeshme.

#### **3.13 Të ardhurat nga penalitetet**

Shoqëria njih të ardhura nga penaliteti në rast tërheqje të parakohëshme të aseteve nga llogaria individuale në fondin e pensionit vullnetar, sipas kërkesave të rregullores nr. 125, datë 07.12.2010 “Për penalitetet e zbatuara në rastin e tërheqjes së parakohëshme nga Fondi i Pensionit Vullnetar”. Penaliteti llogaritet mbi vlerën neto të aseteve të kërkuara për t’u tërhequr para kohe, pasi është zbritur tatimi sipas legjislacionit në fuqi në momentin e tërheqjes. Shoqëria nuk njih të ardhura nga penaliteti në rast tërheqje të parakohëshme nga anëtarët i aseteve nga llogaria individuale në fondin e investimit.

#### **3.14 Përfitimet e punonjësve**

*(i) Kontributet shoqërore të detyrueshme*

Shoqëria paguan kontribute shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Kontributet ndaj planit të pensioneve me kontribut të përcaktuar ngarkohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave kur ato ndodhin. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh të përcaktuara për pensione.

*(ii) Kontributet shoqërore vullnetare*

Shoqëria paguan kontribute shoqërore vullnetare për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Kontributet ndaj planit të pensioneve me kontribut të përcaktuar ngarkohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave kur ato ndodhin.

#### **3.15 Tatimi**

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave të tjera. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi, ose që konsiderohet si e tillë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme sipas ligjit shqiptar të tatimit.

### **3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)**

#### **3.15 Tatimi (vazhdim)**

Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur metodën e bilancit, nga diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe bazës tatimore. Shuma e tatimit të shtyrë është llogaritur duke përdorur normën tatimore në fuqi në datën e mbylljes së diferencave, sipas ligjeve në fuqi në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatuueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit ky aktiv mund të përdoret. Aktiv i tatimor i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet për aq sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

Në përcaktimin e vlerës së tatimit aktual dhe të shtyrë Shoqëria merr në konsideratë impaktin e pozicioneve tatimore të pasigurta dhe tatimet dhe interesat shtesë. Shoqëria beson se përlllogaritjet për detyrimet tatimore janë të mjaftueshme për të gjithë vitet e hapura tatimore në bazë të vlerësimit të shumë faktorëve duke përfshirë interpretimet tatimore dhe eksperiencat e mëparshme.

#### **3.16 Qiratë**

Një qira përcaktohet si "një kontratë, ose pjesë e një kontrate, që përcjell të drejtën për të përdorur një aktiv (aktivin themelor) për një periudhë kohe në këmbim të pagesës". Për të zbatuar këtë përkufizim, shoqëria vlerëson nëse kontrata përmbush tre vlerësime kryesore, të cilat janë:

- Kontrata përmban një aktiv të identifikuar, i cili ose përcaktohet në mënyrë të qartë në kontratë ose specifikohet në mënyrë të qartë duke u identifikuar në kohën kur aktiv i është vënë në dispozicion të shoqërisë
- Shoqëria ka të drejtë të sigurojë në tërësi të gjitha përfitimet ekonomike nga përdorimi i aktivit të identifikuar gjatë gjithë periudhës së përdorimit, duke marrë parasysh të drejtat e tij në qëllimin e caktuar të kontratës
- Shoqëria ka të drejtë të përcaktojë përdorimin e aktivit të identifikuar gjatë gjithë periudhës së përdorimit. Shoqëria vlerëson nëse ka të drejtë të përcaktojë 'si dhe për çfarë qëllimi' aktiv i përdoret gjatë gjithë periudhës së përdorimit.

*(i) Matja dhe njohja e qirave si qiramarrës*

Në datën e fillimit të qirasë, shoqëria njihet një aktiv të së drejtës së përdorimit dhe një detyrim të qirasë në pasqyrat financiare. Aktivet e së drejtës së përdorimit maten me koston, e cila përbëhet nga matja fillestare e detyrimit të qirasë, çdo kosto fillestare direkte e bërë nga shoqëria, një vlerësim i çdo kostoje për çmontimin dhe heqjen e aktivit në fund të qirasë, dhe çdo pagesë e qirasë bërë përpara datës së fillimit të qirasë (neto e çdo incentivi të marrë).

Shoqëria zhvlerëson aktivet e të së drejtës së përdorimit në bazë të drejtpërdrejtë nga data e fillimit të qirasë deri në fund të jetës së dobishme të aktivit të së drejtës së përdorimit ose mbarimit të afatit të qirasë. Shoqëria gjithashtu vlerëson aktivin e së drejtës së përdorimit për zhvlerësim kur ekzistojnë tregues të tillë.

### **4. Manaxhimi i rrezikut financiar**

#### **4.1 Faktorët e rrezikut financiar**

Shoqëria monitoron dhe menaxhon rrezikun financiar që lidhet me operacionet e saj përmes analizave të brendshme të rrezikut të cilat përshkruajnë shkallën dhe rëndësinë e rrezikut. Shoqëria nuk përdor instrumenta financiarë derivativë për t'u mbrojtur nga ekspozimi ndaj këtyre risqeve. Shoqëria gjatë aktivitetit të saj ekspozohet ndaj rreziqeve të mëposhtme:

#### **4. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

##### **4.1 Faktorët e rrezikut financiar (vazhdim)**

- 1) Rreziku i kreditit
- 2) Rreziku i likuiditetit
- 3) Rreziku i tregut
- 4) Rreziku operacional
- 5) Rreziku i biznesit

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj çdo rreziku të përmendur më lart, si dhe politikat dhe procedurat për administrimin e këtyre risqeve.

##### **4.2 Kuadri i Administrimit të Rrezikut**

Sipas ligjit nr.10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, i ndryshuar dhe ligjit “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” nr. 56/2020, miratuar më 30.04.2020. Shoqëria Administruese duhet të ketë një funksion të vecantë për administrimin e rrezikut. Menaxheri i Riskut është përgjegjës për administrimin e rrezikut dhe raporton tek Administratori i Përgjithshëm.

Politikat janë zhvilluar në bazë të strukturës së Fondit të Pensioneve dhe Fondit të Investimit dhe tolerancës së rrezikut të vendosur në politikën e investimeve. Skema e fondëve është e tillë që kontributet janë të përcaktuara, ndërsa përfitimet nuk janë të përcaktuara. Ndarja kryesore është që rreziku mbahet plotësisht nga klientët që kontribuojnë. Toleranca e rrezikut është elementi kryesor që përcakton diferencën midis fondëve nën administrim dhe që së bashku me skemën me kontribute të përcaktuara të fondit, qëndrojnë në thelb të zhvillimit të politikës së menaxhimit të rrezikut.

Për të menaxhuar rrezikun e tregut financiar, Shoqëria ndërmerr një proces që përbëhet nga identifikimi i ekspozimeve, vendosja e limiteve të lejuar të këtyre ekspozimeve, matjen e vazhdueshme të ekspozimeve, monitorimin e limiteve, dhe ekzekutimin e axhustimeve të duhura sadoherë nivelet e ekspozimit gjenden jashtë intervaleve të caktuara, apo dhe menaxhimin e pozicioneve me anë të kontratave derivative. Shoqëria përdor kontratat derivative për fondet vetëm për qëllime eliminimi të risqeve dhe jo për qëllime fitimi nëpërmjet spekulimit.

##### **4.3 Rreziku i kreditit**

Emetuesit e instrumentave financiarë në portofol mund të dështojnë në pagesat e interesit ose kryegjësë. Rënia e cilësisë së kreditit mund të vijë nga rënia në vlerë dhe likuiditetit të instrumentave të tregut. Një rritje në hapësirat e kredisë mund të ulë vlerën e tregut të instrumentave duke sjellë një rënie të përgjithshme në vlerën neto të aktiveve të fondit.

Investimet sipas kategorisë së vendit janë detajuar si më poshtë.

	<b>31 dhjetor 2020</b>	<b>31 dhjetor 2019</b>
<b>Pa vonesa dhe të pazhvlerësuar</b>		
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	8,492,344	24,140,788
Depozita me afat	17,000,000	17,000,000
Aktive të tjera	400,555	407,397
<b>Total</b>	<b>25,892,899</b>	<b>41,548,185</b>

	<b>31 dhjetor 2020</b>	<b>31 dhjetor 2019</b>
<b>Pa vonesa dhe të pazhvlerësuar</b>		
Bono dhe Obligacion të RSH (B+ sipas S&P)	10,139,884	-
<b>Vlera kontabël</b>	<b>10,139,884</b>	<b>-</b>

**“Credins Invest” sh.a, Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive**

Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

**4. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**4.4 Rreziku i likuiditetit**

31 dhjetor 2020	Vlera kontabël	Flukset monetare	Më pak se 1 muaj	1 - 3 muaj	3 - 6 muaj	6 - 12 muaj	1 - 5 vjet	>5 vjet
<b>Aktive Monetare</b>								
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	8,492,344	8,492,344	8,492,344	-	-	-	-	-
Kuota në Fond investimi VDPFH	23,252,619	23,252,619	23,252,619	-	-	-	-	-
Depozita me afat	17,000,000	17,000,000	-	-	-	-	17,000,000	-
Te arkëtueshme nga Fondet	5,498,372	5,498,372	5,498,372	-	-	-	-	-
Aktive të tjera	1,936,741	1,936,741	19026	488,793	132754	1,296,168	-	-
Letra me vlerë me kosto te amortizuar	10,139,884	-	-	-	-	-	-	10,139,884
Interesa të pritshme nga depozitat	-	1,299,452	-	209,589	211,918	428,493	449,452	-
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>66,319,960</b>	<b>57,479,528</b>	<b>37,262,361</b>	<b>698,382</b>	<b>344,672</b>	<b>1,724,661</b>	<b>17,449,452</b>	<b>10,139,884</b>
<b>Detyrimet monetare</b>								
Detyrime qira financiare	4,311,786	4,311,786	359,316	718,631	1,077,947	2,155,893	-	-
Detyrime të tjera	6,424,169	6,424,169	6,424,169	-	-	-	-	-
Interesa të ardhshme nga qiratë	-	141,414	0	59,425	43,538	38,452	-	-
<b>Total i detyrimeve</b>	<b>10,735,955</b>	<b>10,877,369</b>	<b>6,783,485</b>	<b>778,056</b>	<b>1,121,485</b>	<b>2,194,345</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Pozicioni neto</b>	<b>55,584,005</b>	<b>46,602,159</b>	<b>30,478,876</b>	<b>(79,674)</b>	<b>(776,813)</b>	<b>-469,684</b>	<b>17,449,452</b>	<b>10,139,884</b>
<b>Efekti akumuluar</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>30,478,876</b>	<b>30,399,202</b>	<b>29,622,389</b>	<b>29,152,705</b>	<b>46,602,157</b>	<b>56,742,041</b>

**“Credins Invest” sh.a, Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive**

Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

**4 Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**4.4 Rreziku i likuiditetit-(vazhdim)**

31 dhjetor 2019	Vlera kontabël	Flukset monetare	Më pak se 1 muaj	1 - 3 muaj	3 - 6 muaj	6 - 12 muaj	1 - 5 vjet	>5 vjet
<b>Aktive Monetare</b>								
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	24,140,788	24,140,788	4,140,788	20,000,000	-	-	-	-
Depozita me afat	17,000,000	17,000,000	-	-	-	-	17,000,000	-
Të arkëtueshme nga Fondet	5,302,407	5,302,407	5,302,407	-	-	-	-	-
Aktive të tjera	407,397	407,397	191	6,658	-	400,548	-	-
Interesa të pritshme nga depozitat	-	2,173,256	-	232,814	211,338	427,322	1,301,781	-
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>46,850,592</b>	<b>49,023,848</b>	<b>9,443,386</b>	<b>20,239,472</b>	<b>211,339</b>	<b>827,870</b>	<b>18,301,781</b>	-
<b>Detyrimet monetare</b>								
Detyrime të tjera	2,152,519	2,152,519	2,152,519	-	-	-	-	-
Detyrim qira financiare	4,244,512	4,244,512	353,709	707,419	1,061,128	2,122,256	-	-
Interesa të ardhshme nga qiratë	-	139,208	-	58,498	42,858	37,852	-	-
<b>Total i detyrimeve</b>	<b>6,397,031</b>	<b>6,536,239</b>	<b>2,506,228</b>	<b>765,917</b>	<b>1,103,986</b>	<b>2,160,108</b>	-	-
<b>Pozicioni neto</b>	<b>40,453,561</b>	<b>42,487,609</b>	<b>6,937,158</b>	<b>19,473,555</b>	<b>(892,647)</b>	<b>(1,332,238)</b>	<b>18,301,781</b>	-
<b>Efekti akumuluar</b>			<b>6,937,158</b>	<b>26,410,713</b>	<b>25,518,066</b>	<b>24,185,828</b>	<b>42,487,609</b>	<b>42,487,609</b>

**“Credins Invest” sh.a, Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive**

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2020

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

#### **4 Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

##### **4.5 Rreziku i tregut**

Rreziku i tregut përbëhet nga rreziku i normave të interesit dhe rreziku i luhatjes së kurseve të këmbimit.

##### *Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit*

Ekspozimet në monedhë të huaj përmbajnë rrezikun e lëvizjeve jo të favorshme në kursin e këmbimit.

Aktivitet dhe detyrimet financiare në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2020 përbëhen si më poshtë.

<b>Aktive</b>	<b>në LEK</b>	<b>në EUR</b>	<b>Totali</b>
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	8,148,911	343,433	8,492,344
Kuota në Fond investimi	23,252,619	-	23,252,619
Depozita me afat	17,000,000	-	17,000,000
Të arkëtueshme nga Fondet	5,498,372	-	5,498,372
Aktive të tjera	1,936,741	-	1,936,741
Aktive me të drejtë përdorimi		4,311,786	4,311,786
Letra me vlerë	10,139,884	-	10,139,884
<b>Totali aktiveve</b>	<b>65,976,527</b>	<b>4,655,219</b>	<b>70,631,746</b>
<b>Detyrime</b>			
Detyrime të tjera	5,771,064	653,105	6,424,169
Detyrime qera financiare	-	4,311,786	4,311,786
<b>Totali i detyrimeve</b>	<b>5,771,064</b>	<b>4,964,891</b>	<b>10,735,955</b>
<b>Pozicioni Neto</b>	<b>60,205,463</b>	<b>(309,672)</b>	<b>59,895,791</b>

Aktivitet dhe detyrimet financiare në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2019 përbëhen si më poshtë.

<b>Aktive</b>	<b>në LEK</b>	<b>në EUR</b>	<b>Totali</b>
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	24,125,723	15,065	24,140,788
Depozita me afat	17,000,000	-	17,000,000
Të arkëtueshme nga Fondet	5,302,407	-	5,302,407
Aktive me të drejtë përdorimi		4,177,064	4,177,064
Aktive të tjera	407,397	-	407,397
<b>Totali aktiveve</b>	<b>46,835,527</b>	<b>4,192,129</b>	<b>51,027,656</b>
<b>Detyrime</b>			
Detyrime të tjera	1,259,868	892,651	2,152,519
Detyrim qira financiare		4,244,512	4,244,512
<b>Totali i detyrimeve</b>	<b>1,259,868</b>	<b>5,137,163</b>	<b>6,397,031</b>
<b>Pozicioni Neto</b>	<b>45,575,659</b>	<b>(945,034)</b>	<b>44,630,625</b>

##### **4.6 Rreziku operacional**

Rreziku operacional përbën rrezikun e humbjeve nga mosfunksionimi i sistemeve dhe i procedurave të brendshme. Shoqëria ka përpiluar procedura të brendshme dhe sisteme kontrolli për minimizimin e rrezikut operacional. Shoqëria ka krijuar sisteme të brendshme kontrolli që mënjanojnë mosfunksionimin e proceseve.



**“Credins Invest” sh.a, Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive**

**Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2020**

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

**5. Paraqitja me vlerë të drejtë**

Vlerësimet e vlerave të drejta janë bazuar në paraqitjen e pozicionit financiar të instrumenteve ekzistuese financiare pa u përpjekur për të vlerësuar vlerën e biznesit të pritshëm dhe vlerën e aktiveve dhe pasiveve që nuk konsiderohen instrumenta financiarë.

Mjete monetare dhe ekuivalentë me to përbëhen nga mjetet monetare në bankë dhe depozita me afat përfshirë vendosjet ndër-bankare dhe llogaritë e mbledhshme. Duke qenë se depozitat janë afatshkurtra me afat 1 dhe 3 mujor vlera e tyre e drejtë konsiderohet e përafërt me vlerën kontabël.

Letrat me vlerë - Investimet në obligacione janë aktive financiare të vlefshme për shitje, të cilat fitojnë interes.

Për shkak se nuk ekziston një treg aktiv për këto letra me vlerë, vlera e drejtë është vlerësuar duke përdorur një model të skontimit të rrjedhjeve të parasë bazuar në një kurbë të normës të kthimit aktuale të përshtatshme për afatin e mbetur deri në maturim.

	Të mbajtura deri në maturim	Të vlefshme për shitje	Kredi dhe të arkëtueshme	Të tjera me kosto të amortizuar	Totali i vlerës kontabël	Vlera e drejtë
<b>31 dhjetor 2020</b>	-	-	-	-	-	-
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	-	-	-	8,492,344	8,492,344	8,492,344
Kuota në Fond Investimi	-	23,252,619	-	-	23,252,619	23,252,619
Depozita me afat	-	-	-	17,000,000	17,000,000	17,000,000
Të arkëtueshme nga Fondet	-	-	-	5,498,372	5,498,372	5,498,372
Aktive të tjera	-	-	-	1,936,741	1,936,741	1,936,741
Letra me vlerë	-	-	-	10,139,884	10,139,884	10,172,815
Të tjera detyrime	-	-	-	(6,424,169)	(6,424,169)	(6,424,169)
<b>Total</b>	-	<b>23,252,619</b>	<b>0</b>	<b>36,643,172</b>	<b>59,895,791</b>	<b>59,928,722</b>

	Të mbajtura deri në maturim	Të vlefshme për shitje	Kredi dhe të arkëtueshme	Të tjera me kosto të amortizuar	Totali i vlerës kontabël	Vlera e drejtë
<b>31 dhjetor 2019</b>	-	-	-	-	-	-
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	-	-	-	24,140,788	24,140,788	24,140,788
Depozita me afat	-	-	-	17,000,000	17,000,000	17,000,000
Aktive të tjera	-	-	-	1,406,052	1,406,052	1,406,052
Të arkëtueshme nga Fondet	-	-	5,302,407	-	5,302,407	5,302,407
Detyrime të tjera	-	-	-	(3,437,242)	(3,437,242)	(3,437,242)
<b>Total</b>	-	-	<b>5,302,407-</b>	<b>39,109,598</b>	<b>44,412,005</b>	<b>44,412,005</b>

Matja e vlerës së drejtë është përfshirë në informacionin shpjegues të pasqyrave financiare për 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është bazuar në Nivelin 3 të hierakisë.

**“Credins Invest” sh.a, Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive**

**Shënime të shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2020**

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

## 6. Mjete monetare dhe ekuivalentë

Mjetet monetare dhe ekuivalentë me to janë të përbëra si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Llogari në banka në Lek	8,148,911	4,125,723
Llogari në banka në Euro	343,433	15,065
Depozita 1-3 muaj	-	20,000,000
<b>Totali</b>	<b>8,492,344</b>	<b>24,140,788</b>

Depozitat 1-3 muaj përfaqësojnë një depozitë 1 mujore në shumën 10,000,000 LEK pranë Bankës Credins, e cila mbart interes me normë 0.7 % dhe është maturuar me datë 31 janar 2020 dhe një depozitë 3 mujore në shumën 10,000,000 LEK pranë Bankës Credins, e cila mbart interes me normë 0.9 % dhe është maturuar me datë 05 mars 2020.

## 7. Kuota në Fond Investimi

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Kuota në Fond Investimi	23,252,619	-
<b>Totali</b>	<b>23,252,619</b>	<b>-</b>

Gjatë vitit janë blerë 17,882.8923 kuota në Fondin e Investimit Credins Premium. Cmimi i kuotës më 31.12.2020 është 1,300.2717 lekë për kuotë.

Data	Kuota	Çmim i blerjes	Vlerë nominale	Çmim i tregut	Vlerë
19.05.2020	2331.6076	1,286.6659	3,000,000	1,300.2717	3,031,723
06.03.2020	7,758.4822	1,288.9119	10,000,000.00	1,300.2717	10,088,135
10.01.2020	7,792.8025	1,283.2354	10,000,000.00	1,300.2717	10,132,761
<b>Total</b>	<b>17,882.8923</b>		<b>23,000,000</b>		<b>23,252,619</b>

## 8. Depozita me afat

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Depozitë 5 vjeçare	17,000,000	17,000,000
<b>Totali</b>	<b>17,000,000</b>	<b>17,000,000</b>

Depozita me afat përfaqëson depozitën 5 vjeçare me vlerë nominale 17,000,000 Lekë, me normë interesi vjetore 5 %, e cila maturohet më 12 Korrik 2022, vendosur në Bankën Credins.

## 9. Të arkëtueshme nga Fondet

Të arkëtueshme nga Fondet përfaqësojnë vlerën e tarifës së administrimit të përlogaritur mbi aktivet neto të Fondit të Pensionit dhe Fondit të Investimit, të cilat kanë mbetur të papaguar në fund të vitit.

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Të arkëtueshme nga Fondi Pensionit	2,756,037	2,094,597
Të arkëtueshme nga Fondi Investimit	2,742,335	3,207,810
<b>Totali</b>	<b>5,498,372</b>	<b>5,302,407</b>

**“Credins Invest” sh.a, Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive**

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2020

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

**10. Aktive të tjera**

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Parapagime tatim-fitimi	-	10,000
Parapagime për sigurim jete dhe shëndeti – stafi	531,016	358,550
Parapagim qera	630,105	630,105
Parapagime web	356,039	-
Të arkëtueshme staf	19,026	-
Interesa të arkëtueshme	400,555	407,397
<b>Totali</b>	<b>1,936,741</b>	<b>1,406,052</b>

Interesa të arkëtueshme përfaqësojnë interesat e përllogaritura mbi depozitat në datën e raportimit. Parapagime për web përfshijnë parapagime për V Advertising për zhvillim dhe dizajn web-i sipas kontratës së lidhur në korrik 2020.

**11. Aktive me të drejtë përdorimi**

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Gjendja më 1 janar	4,177,064	8,354,127
Shtesa	4,311,786	-
<b>Total</b>	<b>8,488,850</b>	<b>8,354,127</b>
Shpenzime amortizimi	4,177,064	4,177,063
<b>Gjendja në fund</b>	<b>4,311,786</b>	<b>4,177,064</b>

Shoqëria ka lidhur kontratë qiraje më datë 07 janar 2019 për ambientet e zyrave me afat një vjeçar me të drejtë rinovimi.

**12. Letra me vlerë**

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Obligacion 10 vjeçar (vlera nominale)	10,000,000	-
Premium/discount	(80,516)	-
Interes i përllogaritur	220,400	-
	<b>10,139,884</b>	<b>-</b>

Investimi në obligacion të Qeverisë shqiptare është kryer në datë 14 tetor 2021 (rihapje e emetimit dt.28 korrik 2020), me vlerë nominale 10 milion lekë, normë kuponit 5.22%.

**“Credins Invest” sh.a, Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kollective**

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2020

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

**13. Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara, neto**

	Sisteme elektronike	Totali
<b>Kosto</b>		
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	9,701,587	9,701,587
Shtesa	-	-
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2020	9,701,587	9,701,587
<b>Zhvlerësimi i akumuluar</b>		
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	(6,719,519)	(6,719,519)
Shpenzimi për periudhen	(745,512)	(745,512)
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2020	(7,465,031)	(7,465,031)
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	2,982,068	2,982,068
Gjendja më 31 Dhjetor 2020	2,236,556	2,236,556

**14. Aktive të qëndrueshme të trupëzuara, neto**

	Pajisje zyre	Pajisje informatike	Totali
<b>Kosto</b>			
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	4,392,408	5,400,446	9,792,854
Shtesa		1,897,555	1,897,555
Pakësime		(45,075)	(45,075)
Gjendja më 31 Dhjetor 2020	4,392,408	7,252,926	11,645,334
<b>Zhvlerësimi i akumuluar</b>			
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	(1,013,882)	(3,434,297)	(4,448,179)
Shpenzimi për periudhen	(675,708)	(594,638)	(1,270,346)
Pakësime	-	19,197	19,197
Gjendja më 31 Dhjetor 2020	(1,689,590)	(4,009,738)	(5,699,328)
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	3,378,526	1,966,149	5,344,675
Gjendja më 31 Dhjetor 2020	2,702,818	3,243,188	5,946,006

**“Credins Invest” sh.a, Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kollective**

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2020

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

**15. Detyrime të tjera**

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Shërbime profesionale	504,449	487,730
Detyrime për taksa, TVSH, dhe sigurime shoqërore	1,002,962	926,492
Detyrim tatim fitimi	3,008,034	358,231
Shpenzime të tjera të përlogaritura	8,239	16,666
Shpenzime të përlogaritura për bankën depozitare FP	124,022	94,257
Shpenzime të përlogaritura tarife	147,431	71,613
Furnitorë	1,629,032	1,388,580
Detyrim ndaj Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare	-	93,673
<b>Total</b>	<b>6,424,169</b>	<b>3,437,242</b>

Vlera detyrimit tatimor për vitin 2020 është 3,276,262 lekë dhe parapagimet e paguara prej 268,228 lekë kanë pakësuar detyrimin përkatës.

**16. Detyrime të qirasë financiare**

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Gjendja më 1 janar	4,244,512	8,354,127
Shtesa	4,311,786	-
Shpenzimi i interesit	142,179	390,791
Humbje/fitim nga kursi i këmbimit	76,683	(66,496)
Kestet e qirasë për vitin	(4,463,374)	(4,433,910)
<b>Gjendja më 31 dhjetor</b>	<b>4,311,786</b>	<b>4,244,512</b>

**17. Kapitali Aksionar**

Më 31 Dhjetor 2020, kapitali aksionar i regjistruar është 95,822,394 Lekë, dhe përbëhet nga 233,713 aksione me vlerë nominale Lek 410 (2019: Kapitali aksionar 95,822,394 Lekë). Struktura aksionare bazuar në kapitalin e paguar tërësisht dhe të regjistruar ishte si vijon:

Ky miratim ndryshoi strukturën aksionare të shoqërisë si me poshtë:

	31 dhjetor 2020			31 dhjetor 2019		
	Në %	Numër aksionesh	Në Lek	Në %	Numër aksionesh	Në Lek
CREDINS Bank	76%	177,622	72,825,019	76%	177,622	72,825,019
SiCRED Sh.a.	12%	28,046	11,498,687	12%	28,046	11,498,687
Estela Koçi	5%	11,685	4,791,120	5%	11,685	4,791,120
Genc Koxhaj	3,5%	8,180	3,353,784	3,5%	8,180	3,353,784
Egj Santo	3,5%	8,180	3,353,784	3,5%	8,180	3,353,784
	<b>100%</b>	<b>233,713</b>	<b>95,822,394</b>	<b>100%</b>	<b>233,713</b>	<b>95,822,394</b>

Autoriteti Mbikqyrjes Financiare, me anë të Vendimit nr. 27 datë 04.03.2019, ka dhënë miratimin si aksionar ndikues i Znj. Estela KOCI, e cila bëhet zotëuese prej 5 % e paketës aksionare. Me anë të vendimit nr 28 datë 28.04.2019, Autoriteti Mbikqyrjes Financiare ka dhënë miratimin për ndryshimet e statutit të Shoqërisë.

Me Vendimin 1, datë 26.05.2020 Asambleja Aksionarëve miratoi shpërndarjen e rezultatit të vitit 2019, në masën 80% . Vlera 9,328,021 lekë ka kaluar në zërin humbje të mbartura, ndërsa 20% në vlerë prej 2,332,005 lekë shpërndarje dividendi.

**“Credins Invest” sh.a, Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive**

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2020

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

**18. Të ardhura nga tarifa e administrimit**

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga tarifa administrimit Fondi i Pensionit	28,718,995	21,079,243
Të ardhura nga tarifa administrimit Fondi i Investimit	34,875,703	31,234,090
<b>Total</b>	<b>63,594,698</b>	<b>52,313,333</b>

Shoqëria mban një tarifë administrimi prej 3% në vit mbi vlerën neto të asetëve të Fondit të Pensioneve dhe një tarifë prej 1% në vit mbi vlerën neto të asetëve të Fondit të Investimit. Këto tarifa llogariten në bazë ditore nga secili Fond.

**19. Të ardhurat nga penalitete**

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga penalteti për tërheqje të parakohëshme nga Fondi i Pensionit	1,855,336	1,870,341
<b>Total</b>	<b>1,855,336</b>	<b>1,870,341</b>

Siç përshkruhet në Rregulloren 125, datë 07.12.2010 “Për penaltetet e zbatuara në rastin e tërheqjes së parakohëshme nga Fondi Pensionit Vullnetar”, Shoqëria ka njohur të ardhura nga penaltetet. Nuk ka penaltet nga tërheqjet nga Fondi i Investimit.

**20. Të ardhura nga interesat**

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Interesa nga depozitat	884,965	928,574
Interesat nga llogarite rrjedhëse dhe fondi investimit	252,619	407
Amortizim premium/skonto obligacioni	10,888	-
Të ardhura nga kuponit i letrave me vlerë	110,200	-
<b>Total</b>	<b>1,258,672</b>	<b>928,981</b>

**21. Të ardhura nga dhurata dhe ndihma të marra**

Banka Credins (aksioneri kryesor i Shoqërisë), bazuar në Kontratën e Dhurimit datë 18.12.2019, i ka dhuruar Shoqërisë një televizor me një vlerë totale prej 62,824 Lek.

**22 Shpenzime për personelin**

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Paga dhe shpërblime	23,247,100	21,617,184
Sigurime shoqërore	2,587,564	2,424,288
Pension Privat	315,000	370,000
Sigurim jete dhe shëndeti	244,115	304,163
<b>Totali</b>	<b>26,393,779</b>	<b>24,715,635</b>

**“Credins Invest” sh.a, Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive**

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2020

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

**23. Shpenzime të përgjithshme administrative**

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Mirëmbajtje software	2,709,719	2,168,051
Shpenzime marketing, aktivitete, design	2,816,283	2,562,512
Tarifë për depozitarin FP	1,292,355	1,083,279
Asistencë nga palë të treta	1,081,705	972,835
Siguracion	904,000	808,900
Shpenzime të tjera	801,805	757,601
Shërbime profesionale	521,417	487,730
Energji	584,135	419,768
Tarifë për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare FP	477,771	441,100
Tarifë për Këshillin Mbikëqyrës	150,000	100,000
Komisione bankare	428,635	505,084
Shpenzime postare dhe telefonike	302,640	213,150
Kancelari	106,001	179,451
Taksa vendore dhe tarifa regjistrimi	326,920	348,146
Shpenzime pritje	168,193	135,434
Komision agjenti Fondi i investimit	160,263	378,820
<b>Total</b>	<b>12,831,842</b>	<b>11,561,861</b>

**24. Tatimi mbi fitimin**

Një rakordim i shpenzimit të tatim fitimit për vitin që mbaron më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Fitim/(Humbja) për periudhën	21,015,320	12,085,705
Shpenzime jo të zbritëshme	826,427	370,630
Humbje tatimore të mbartura nga vitet e mëparshme	-	-10,068,126
<b>Humbjet fiskale të mbartura</b>	<b>-</b>	<b>2,388,209</b>
Tatim fitimi sipas normës së përqindjes vendore	15%	15%
<b>Shpenzim tatimor i vitit</b>	<b>3,276,262</b>	<b>358,231</b>

Në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar, norma e aplikueshme e tatimit për vitin 2020 është 15% (2019: 15%). Deklaratat tatimore janë plotësuar për çdo vit por fitim-humbjet e deklaruara për qëllime tatimore mbeten si parashikime derisa autoritetet tatimore kontrollojnë ato dhe regjistrimet e taksapaguesit dhe lëshohet një vlerësim final.

Shoqëria për vitin 2020 dhe 2019 nuk njeh aktiv tatimor të shtyrë përpara i takon humbjeve për efekt fiskal, sepse drejtimi gjykon se fitimet e pritshme tatimore të Shoqërisë nuk janë të sigurta sa të përdoren për kompesimin e humbjeve tatimore të mbartura.

Sipas ligjit të tatimit mbi fitimit Shoqëria mund të mbartë humbjet tatimore në tri periudhat e ardhshme tatimore, sipas parimit “humbja e parë më përpara se ajo e fundit”. Në rast se gjatë një periudhe tatimore pronësia e drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë e kapitalit themeltar ose e të drejtave të votës, të një personi, ndryshon me më shumë se 50 për qind, në vlerë ose në numër, paragrafi i mësipërm nuk zbatohet për humbjet e pësuar nga ai person juridik në atë periudhë tatimore dhe në periudhat paraardhëse të tatimit”

**“Credins Invest” sh.a, Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive**

**Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2020**

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

## 24. Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

Tabela e humbjeve të mbartura të Shoqërisë paraqitet si më poshtë.

Viti	Fitimi/(Humbjet Financiare)	Shpenzime jo te zbritshme	Fitimi fiskal/(humbjet fiskale)	Total
2016	(9,965,987)	704,186	(9,261,801)	(9,261,801)
2017	(5,851,621)	707,721	(5,143,900)	(14,405,701)
2018	4,328,353	9,222	4,337,575	(10,068,126)

Ligjet tatimore shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore. Shpenzimet e palejuara për efekte tatimore paraqesin shpenzime të pambështetura me dokumentacionin përkatës apo shpenzime të konsideruara të panjohura për efekte fiskale.

## 25. Angazhime dhe detyrime të konstatuara

Në rrjedhën normale të biznesit shoqëria mund të përballet me pretendime ligjore, por deri në fund të vitit nuk ka pasur pretendime të tilla. Drejtimi i Shoqërisë ka opinionin që nuk do të ndodhin humbje materiale në lidhje me ndonjë pretendim ligjor deri më 31 dhjetor 2020.

### Detyrime qiramarrje

Shoqëria ka hyrë në një angazhim qiraje operative më 07 janar 2019 me afat 1 vit dhe të drejtë rinovimi në vlerën mujore 3,000 Euro (bruto).

## 26. Transaksionet me palët e lidhura

Palë e lidhur konsiderohet një entitet që ka aftësinë të kontrollojë apo të ushtrojë një influencë të konsiderueshme mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe operacionale, apo palët janë nën kontroll të përbashkët me Shoqërinë. Një numer i caktuar transaksionesh me palë të lidhura janë ndermarrë gjatë aktivitetit operacional të shoqërisë. Këto transaksione janë bërë sipas afateve dhe normave të tregut. Transaksionet me fondin e Investimit edhe Fondin e Pensionit janë të paraqitura në shënimin 8 dhe shënimin 17.

Volumi i këtyre transaksioneve dhe balancat në fund të periudhave respektive janë si vijojnë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
<b>Aktive</b>		
CREDINS sh.a.	20,183,005	40,885,011
Abi Bank	2,940,998	380,794
Tirana Bank	2,768,896	282,380
<b>Detyrime</b>		
CREDINS sh.a.	147,431	71,613
Tirana Bank	124,022	94,257
	<b>Viti i mbyllur më</b>	<b>Viti i mbyllur më</b>
	<b>31 dhjetor 2020</b>	<b>31 dhjetor 2019</b>
<b>Shpenzime</b>		
CREDINS sh.a.	1,163,167	944,141
SiCRED shoqëri Sigurimi Jete	1,155,713	1,270,319
SiCRED Assistance	162,000	162,000
Abi Bank	285,126	-
Tirana Bank	1,332,122	1,083,279
<b>Të ardhura nga dhurime dhe interesa</b>		
CREDINS sh.a.	884,965	991,805
<b>Shpërblimet e drejtimit</b>	<b>7,463,000</b>	<b>6,102,381</b>



## **27. Ngjarje pas datës së raportimit**

Më 26 Mars 2021, Bordi Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare ka miratuar regjistrimin e Fondit të Investimeve Alternative për klientët profesionistë dhe të kualifikuar. Fondi investimit alternativ “Sea Land Alternative Investment Fund”- Shoqëri Komandite SIK, do të administrohet për periudhën në vazhdim nga shoqëria administruese në përputhje në përputhje me Ligjin nr. 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”.

Nuk ka ngjarje pas datës së bilancit që mund të kërkojë korigjim ose shënime shtesë në pasqyrat financiare të shoqërisë.